



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr.5, datë 16.04. 2020

MBI

“PEZULLIMIN E AFATIT TË SHQYRTIMIT TË ANKIMIT ADMINISTRATIV TË OFRUESIT TË SHËRBIMEVE UNIVERSALE POSTARE, POSTA SHQIPTARE SH.A, KUNDËR MASËS ADMINISTRATIVE TË DËNIMIT ME GJOBË, SI PASOJË E SHPALLJES SË GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Znj.	Xhoana	Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 16/04/2020, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 62, të Ligjit Nr. 46/2015, datë 07.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe Ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Mbi pezullimin e afatit të shqyrtimit të ankimit administrativ të ofruesit të shërbimeve universale postare, “Posta Shqiptare sh.a”, kundër masës administrative të dënimit me gjobë, si pasojë e shpalljes së gjëndjes së fatkeqësië natyrore.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 170 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
2. Neni 60 e vijues i Ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr.46/2015*);
3. Pika 4, neni 91 dhe Nenet 128 e vijues të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, (*Ligji nr.44/2015*);

4. Akti Normativ i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19” (*Akti Normativ nr.3/2020*);
5. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” (*VKM nr.243/2020*);
6. Kapitulli III, Nenet 27 dhe 28 të Rregullores Nr. 45 datë 27.10.2016, “Metodikë Inspektimi i veprimtarisë së ofruesve të Shërbimeve Postare”, miratuar me Vendimin Nr. 2694 datë 27.10.2016, të Këshillit Drejtues të AKEP;
7. Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP (Rregullore nr.7).

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankimi administrativ i ofruesit të shërbimeve universale postare “Posta Shqiptare”, sh.a, depozituar në AKEP me datë 09.03.2020, me Nr. 2383/9 *Prot.* i AKEP;
2. Projekt–Vendimin e formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacionin shoqërues të Projekt-Vendimit, të hartuar nga Komisioni *ad hoc* i ngritur për shqyrtimin e ankimit administrativ (Relacioni);
4. Praktikën e plotë të inspektimit, e cila përmban materialet si vijon:
Autorizimin e Inspektimit Nr.2383 Prot, Datë 19.11.2019;
Procesverbalin e Inspektimit;
Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr.1, datë 18.02.2020;
Gjobën me nr.1, datë 18.02.2020.
5. Relacioni i Drejtorisë së Monitorimit, Kontrollit dhe Inspektimit me nr.812 prot, datë 10.04.2020, “Mbi marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID 19 nga ofruesi i shërbimit universal postar “Posta Shqiptare sh.a. dhe sipërmarrësit e tjerë të autorizuar nga AKEP për të ofruar shërbime postare”.

Si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen dhe bazës ligjore të lartpërmendur,

V Ë R E N:

I. Vlerësimi Paraprak:

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankimit administrativ të ofruesit të shërbimeve postare “Posta Shqiptare”, sh.a, ndaj aktit administrativ gjobë të vendosur nga inspektorët e AKEP (*GI*), Këshilli Drejtues i AKEP konstatoi se sipërmarrësi në fjalë legjitimohet plotësisht për të paraqitur ankim administrativ, pasi paraqet *prima facie* interes në këtë procedurë, bazuar në nenin 62, të *ligjit nr. 46/2015*.
2. Ankimi ndaj aktit administrativ Gjobë, nr.1, datë 18.02.2020 të vendosur nga AKEP, është paraqitur nga ofruesi i shërbimit postar Posta Shqiptare sh.a. në datën

09.03.2020, ndërkohë që kjo e fundit ka marrë dijëni për aktin administrativ në fjalë në datë 24.02.2020.

3. Në vëmendje sa më sipër, rezulton se sipërmarrësi ankimues ka paraqitur ankim administrativ brenda afatit 15 ditor, të parashikuar në nenin 62, të **ligjit nr. 46/205**, si dhe pikës 27, Kapitulli III, të Rregullores Nr. 45 datë 27.10.2016, “Metodikë Inspektimi i veprimtarisë së ofruesve të Shërbimeve Postare”, miratuar me Vendimin Nr. 2694, datë 27.10.2016 të Këshillit Drejtues.
4. Në këto kushte, vlerësohet se ankimi administrativ plotëson efektivisht të gjitha kushtet formale për pranimin e ankimit dhe shqyrtimin e tij, të parashikuara në nenin 135 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

KËSHILLI DREJTUES I AKEP

Pasi mori në shqyrtim faktin se ankimi është i pranueshëm nga ana formale dhe i plotëson të gjitha kushtet ligjore si dhe duke pasur parasysh situatën e fatkeqësisë natyrore në vend, për shkak të pandemisë COVID-19,

A R S Y E T O N:

5. Në kuadrin e misionit të tij ligjor, Këshilli Drejtues i AKEP ka për detyrë edhe mbikëqyrjen e garantimit të vijimësisë dhe të mirëfunksionimit të shërbimeve postare, posaçërisht të shërbimit universal, përfshirë edhe në kohë krize apo në situata emergjence kombëtare siç është edhe ajo me të cilën përballet vendi dhe shërbimet publike prej datës 12 mars 2020. Masat e ndërmarra në këtë kontekst nga autoritetet publike kompetente, me qëllim sidomos ruajtjen e shëndetit të qytetarëve, synojnë distancimin social, kufizimin e qarkullimit dhe të marrjes së disa shërbimeve pranë subjekteve të caktuara të cilat i ofrojnë ato në mjedise publike. Këto masa janë përmbledhur në Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.03.2020, “*Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19*” (**Akti Normativ nr.3/2020**)
6. Sikurse përcaktohet shprehimisht në Nenin 3, “*Masat e veçanta administrative*”, të Aktit normativ nr.3/2020: “*...Organet e shërbimit postar duhet të garantojnë vazhdimësinë e shërbimit dhe të hartojnë një plan masash për të kufizuar kontaktet e punonjësve me publikun dhe për të shmangur grumbullimin në sportele apo në ambiente të tjera të brendshme*”, shërbimi postar është i një rëndësie dhe i një domosdoshmërie të tillë që duhet të sigurohet në çdo rrethanë, në mënyrë të pandërprerë dhe me një angazhim të shumëfishuar në ndihmë të qytetarëve. Vlen të konstatohet se posta shqiptare si ofruese e shërbimit universal, përveç shpërndarjes dhe dorëzimit të objekteve postare në terren, nëpërmjet aktivizimit të gjithë mjeteve saj të logjistikës dhe flotës së automjeteve që disponon, siguron edhe marrjen në ngarkim të disa shërbimeve të tjera me rëndësi për shoqërinë, në veçanti në lidhje me trajtimin e kategorive në vështirësi siç janë pensionistët.

7. Në këto kushte, përcaktimin ligjor të shprehur në nenin 6, pika 2, të Aktit Normativ nr.3/2020: “...Zbatimi i këtij akti normativ, për kohëzgjatjen e periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, ka përparësi ndaj dispozitave të akteve të tjera lidhur me masat administrative...”, KD e gjykon në këto momente të fatkeqësisë natyrore, si të paanashkalueshëm, dhe në përpjestim të drejtë me nevojat e mirëfunksionimit të shërbimeve esenciale, një prej të cilëve është dhe shërbimi postar.
8. Për më tepër, Këshilli Drejtues i AKEP, arsyeton se ka vend për të marrë në konsideratë kombinimin e pikës 4, të nenit 91 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe VKM nr. 243/2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, i cili i dikton institucionit publik përcaktimin e një afati të ri për të plotësuar dhe përfunduar procedurën administrative, në kuptimin e shqyrtimit në themel të ankimit.
9. Në këto kushte, Këshilli Drejtues i AKEP, vëren si të detyrueshëm pezullimin e procedurës administrative dhe vlerëson se të drejtat dhe interesat e ligjshme të palës nuk çënohen nga ky pezullim i diktuar nga situata e fakeqësisë natyrore, përkundrazi përftojnë garanci edhe më të qenësishme në pikëpamjen e procesit të rregullt ligjor. Në kuptim të procesit të rregullt ligjor, Këshilli Drejtues i AKEP, i referohet natyrisht dhe konkretizimit të së drejtës së palës ankimuese për t’u dëgjuar, në seancë të rregullt dëgjimore e për të parashtruar gjithë argumentet e saj, sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 63 të Ligjit nr.46/2015, si dhe të nenit 87 të Ligjit nr.44/2015.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 91 të Ligjit nr.44/2015, “Për Kodin e Procedurave Administrative, në RSH”, nenit 62 të Ligjit nr.46/2015, nenit 28 të Rregullores nr.45/2016, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Pezullimin e afatit të shqyrtimit të ankimit administrativ të ofruesit të shërbimeve universale postare, “Posta Shqiptare sh.a”, kundër masës administrative të dënimit me gjobë, deri në përfundimin e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore dhe në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative.
2. Të njoftohet ofruesi i shërbimeve universale postare “Posta Shqiptare sh.a.”.
3. Ngarkohet Drejtoria e Monitorimit, Kontrollit dhe Inspektimit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare online të AKEP, www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Ketrin TOPÇIU	Xhoana LILAJ